



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 dhjetor 2020
Nr. ref.: RK 1668/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI237/19 dhe KI238/19

Parashtrues

Ekzon Keka dhe Muhamet Thaçi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pn. II. 8/2019 të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, të 17 tetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI237/19 është dorëzuar nga Ekzon Keka, me vendbanim në Kamenicë, i përfaqësuar nga Driton Musliu, avokat. Kërkesa KI238/19 është dorëzuar nga Muhamet Thaçi, me vendbanim në fshatin Muçivërc, komuna e Kamenicës, i përfaqësuar nga Florent Latifi, avokat (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesave).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesave kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Pn. II.8/2019, të 17 tetorit 2019, në ndërlidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 259/2018, të 5 nëntorit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesave të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesit e kërkesave gjithashtu kërkojnë caktimin e masës së përkohshme për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burg, deri në vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 dhjetor 2018, parashtruesit e kërkesave i dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatë.
7. Më 30 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues për rastin KI237/19, si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 14 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës, në pajtim me paragrafin (1), të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, urdhëroi bashkimin e kërkesës KI237/19 me kërkesën KI238/19
9. Më 27 janar 2019, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesave për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave. Të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre.

10. Më 25 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesit e kërkesave parashtrojnë për herë të dytë kërkesa në Gjykatë.

Përmbledhja e fakteve të kërkesave të mëparshme KI19/19 dhe KI20/19

12. Më 1 dhe 6 shkurt 2019, parashtruesit e kërkesave në Gjykatë dorëzuan kërkesat KI19/19 dhe KI20/19, ku kontestonin kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml.nr.259/2018, të 5 nëntorit 2018, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, P.nr.62/2014, të 7 qershorit 2018. Parashtruesit e kërkesave kanë kërkuar gjithashtu vendosjen e masës së përkohshme me qëllim pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burg deri në vendimmarrjen e Gjykatës.
13. Më 29 korrik 2019, Gjykata, pasi i analizoi kërkesat e parashtruesve të kërkesës, vendosi: 1) t'i deklarojë kërkesat e tyre të papranueshme, si qartazi të pabazuara, në lidhje me pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave kushtetuese nga ana e Gjykatës Supreme me Aktvendimin Pml. nr. 259/2018, të 13 gushtit 2018, sepse të njëjtit nuk kishin dëshmuar dhe nuk kishin mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, dhe 2) t'i deklarojë të papranueshme, si të paafatshme, pretendimet për shkelje të të drejtave nga ana e Gjykatës së Apelit me Aktgjykimin PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018, sepse nga pranimi i Aktgjykimit, kishin kaluar më tepër se 4 (katër) muaj për dorëzimin e kërkesave në Gjykatë. Gjykata, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesat e parashtruesve të kërkesës për masë të përkohshme i refuzoi, sepse të njëjtat nuk mund të ishin më objekt shqyrtimi, pasi kërkesat u deklaruan të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve të kërkesave të tanishme KI237/19 dhe KI238/19

14. Më 8 tetor 2019, parashtruesit e kërkesave parashtroan kërkesë për rishikimin e procedurës penale, duke u bazuar në faktin se kërkesën e mëparshme e kanë bërë vetë palët, e të cilët gëzojnë cilësinë e palës për të parashtuar një kërkesë të tillë dhe se Gjykata Supreme gabimisht ka konstatuar se parashtresa ishte dorëzuar nga palët e paautorizuara.
15. Më 17 tetor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Pn. II. 8/2019, refuzoi si të pabazuar, kërkesën e përbashkët të parashtruesve të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, me të cilën u lejua për shqyrtim në merita kërkesa e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1. nr. 748/18, të 13 gushtit 2018.
16. Pjesë relevante nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme:

“Në kërkesën e përbashkët të të dënuarve Egzon Keka dhe Muhamet Thaqi, pretendohet se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase i njëjti është konfuz dhe i paqartë. Në dispozitivin e këtij aktgjykimi thuhet se aprovohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ndërsa në arsyetimin e aktgjykit thuhet se Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar ka gjetur se ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan nuk është e bazuar. Nga kjo shihet se dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykit janë në kundërshtim njëri me tjetrin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, meqë Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit kundër të cilit është paraqitur kërkesa, nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan e ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan -dega në Kamenicë përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe të dënuarve për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtorë ju ka shqiptuar dënimet siç është paraqitur si në arsyetimin si më lart të këtij aktgjykimi. Mirëpo qëndron fakti se në arsyetimin e Aktgjykit të Gjykatës së Apelit në faqen 2 është bërë një gabim teknik ku thuhet se ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan nuk është e bazuar, por ky gabim teknik nuk e bënë aktgjykimin të pakuptueshëm e aq me pak të ketë ndonjë paqartësi në mes të dispozitivit dhe arsyetimit sepse në tërë arsyetimin e aktgjykit jepen arsye të duhura për faktet vendimtare përkitazi me vendimin mbi dënimin, andaj vetëm lëshimi i një gabimi teknik Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit nuk e bënë të paqartë, dhe ky gabim nuk ka mundur të ndikojë në ligjshmërinë e këtij aktgjykimi.

Po ashtu, në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit pretendohet se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të ligjit penal nga neni 385 par. 1. pika 1.5 e KPRK-së, ngase me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim ka përkeqësuar pozitën e të dënuarve pasi që nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese të parapara nga neni 74 të KPRK-së por ka marrë për bazë vetëm rrethanat rënduese.

Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, rezulton se të gjitha pretendimet kanë të bëjnë me vendimin për dënimin.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se konform dispozitës së nenit 385 par.5 të KPPK-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e Ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënimin, dënimin alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm, për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar rrethanat lidhur me dënimin, ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë me ligj dhe përmes individualizimit të dënimit të dënuarit i ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të paraparë për këtë vepër penale.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e Aktgjykimit është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlidhet me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur. Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të mbrojtura me Kushtetutë.
18. Parashtruesi i kërkesës Ekzon Keka kërkon nga Gjykata: *“...vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PN .II. 8/2019, të datës 17.10.2019 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. Nr. 748/2018 i datës 13.08.2018. (Gjithashtu në lidhje me këtë rast i referohemi edhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI104/16 e datës 4.08.2017, si praktikë gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese meqë është rast i ngjashëm). Po ashtu në lidhje me këtë kërkojmë që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të vendos masë të përkohshme për të pezulluar ekzekutimin e dënimit me burg për të pandehurin Egzon Keka derisa të merret një vendim meritator nga Gjykata Kushtetuese”.*
19. Ndërsa parashtruesi Muhamet Thaçi, kërkon nga Gjykata: *“...ta anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 259/2018 të datës 5.11.2018, me të cilin shpallet si e papranueshme kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vlerësohet kërkesa vetëm nga aspekti procedural se nuk i plotëson kushtet. Po ashtu kërkojmë që të anulohet edhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018 i datës 13.08.2018, me anë të të cilit, të pandehurit i shqiptohet dënim i ri me burg efektiv pa i ftuar në seancë dhe me këtë shkelet neni 31 i Kushtetutës së Kosovës (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) lidhur me nenin 6 (e drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligi dhe të parapara me Rregullore të punës.
21. Për sa i përket pranueshmërisë së kërkesave të rasteve konkrete, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

22. Në vazhdim, Gjykata u referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

23. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesave janë palë të autorizuar dhe e kontestojnë një akt të autoritetit publik, pasi i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion. Parashtruesit e kërkesave gjithashtu i kanë sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendohet se u janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe i kanë dorëzuar kërkesat brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
24. Megjithatë, Gjykata i referohet po ashtu Rregullores së punës, në rastin konkret, rregullit 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës], nënrrregullit (5) dhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënrrregullit (2), që përcaktojnë:

Rregulli 35 “(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër...nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze”.

[...]

Rregulli 39 “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

[...]

25. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesit e kërkesave në Gjykatë kontestojnë kushtetutshmërinë: **i.** e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018, në lidhje me të cilin, në rrethana të ngjashme i referohen Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KI104/16, të 4 gushtit 2017, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, **ii.** Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 259/2018, të 5 nëntorit 2018, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë; dhe **iii.** Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PN. II. 8/2019, të 17 tetorit 2019, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë.
26. Gjykata, në përputhje me rregullin 35, nënregullin (5) të Rregullores së punës rikujton se nuk mund t'i shqyrtojë pretendimet e përsëritura të parashtruesve të kërkesave të cilat ishin objekt i shqyrtimit në Gjykatë, në rastet KI19/19 dhe KI20/19. Më saktë, Gjykata nuk do të vlerësojë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018 dhe kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 259/2018, të 5 nëntorit 2018, sepse të njëjtat ishin objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese në rastet e bashkuara KI19/19 dhe KI20/19, për të cilat kishte vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri, të 29 korrikut 2019.
27. Në këtë kuptim, në rrethanat e rasteve para nesh, Gjykata do të vlerësojë vetëm kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PN. II. 8/2019, të 17 tetorit 2019, i cili nuk ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata në rastet e lartpërmendura.
28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave, në mënyrë të përgjithësuar, pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PN. II. 8/2019, i 17 tetorit 2019, shkel të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me Kushtetutë. Megjithatë, të njëjtit nuk shpjegojnë tutje, se si dhe pse, ka ardhur deri të shkelja e të drejtave të tyre kushtetuese me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PN. II. 8/2019, të 17 tetorit 2019.
29. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës pranë Gjykatës Supreme, ndërlidheshin me mosvërtetimin objektiv të fakteve të rastit përkitazi me ushtrimin e kërkesave të përbashkëta për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018, ku Gjykata Supreme kishte refuzuar kërkesat e tyre, duke konsideruar se ishin ushtruar nga palët e paautorizuara sepse kërkesave nuk i ishin bashkëngjitur, si dëshmi, autorizimet e mbrojtësve. Në kërkesën për rishikimin e procedurës penale, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka pranuar shqyrtimin e meritave të kërkesave të përbashkëta për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka analizuar pretendimet e parashtruesve të kërkesave për shkelje esenciale të ligjit material dhe procedural nga Gjykata e Apelit.
30. Në vazhdim, Gjykata vë në pah se Gjykata Supreme në bazë të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, ushtruar nga parashtruesit e kërkesave, më 8 tetor 2019, kishte lejuar shqyrtimin e meritave të kërkesës së përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesve të kërkesave dhe pasi kishte analizuar

pretendimet e tyre, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 13 gushtit 2019, kishte vendosur që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, t'i refuzonte si të pabazuara.

31. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme, e cila sipas detyrës zyrtare, kujdeset për ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët, i është përgjigjur veç e veç secilit prej pretendimeve të ngritura nga parashtruesit e kërkesave, në kërkesat e përbashkëta për mbrojtje të ligjshmërisë, duke dhënë arsye gjithëpërfshirëse dhe të detajuar për arsyet e refuzimit si të pabazuara të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre (shih më lart arsyetimin e detajuar të Gjykatës Supreme, në paragrafin 22).
32. Gjykata tutje vlerëson se parashtruesit e kërkesave kanë pasur mundësi të mjaftueshme që para Gjykatës Supreme t'i prezantojnë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tyre. Për më tepër, Gjykata konsideron se argumentet e tyre janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga Gjykata Supreme. Andaj Gjykata thekson se procedurat e zhvilluara në Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare që do ta bënin procesin të parregullt në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykimi i 30 qershorit 2009).
33. Gjykata tutje rikujton se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj.
34. Edhe më tej, është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNJ rasti *Perlala kundër Greqisë*, paragrafi 25 dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu, rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41). Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore.
35. Gjykata në këtë aspekt thekson se parashtruesit e kërkesave thjeshtë janë të pakënaqur me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, andaj pakënaqësia e tyre nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

36. Në këtë kontekst, Gjykata, shikuar procedurën në tërësi të zhvilluar pranë Gjykatës Supreme, konstaton se kërkesat e parashtruesve të kërkesave duhet të shpallen të papranueshme, si qartazi të pabazuara, sepse parashtruesit e kërkesave në asnjë mënyrë nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre, në baza kushtetuese për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese.

Kërkesa për masë të përkohshme

37. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesave kanë kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burg, deri në vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës.
38. Gjykata sapo ka kolauduar se kërkesat e parashtruesve të kërkesave duhet deklaruar të papranueshme në kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.
39. Prandaj, në pajtim me nenin 27 (1) të Ligjit dhe rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesat e parashtruesve të kërkesave për masë të përkohshme duhet të refuzohen, sepse të njëjtat nuk mund të jenë tutje objekt i shqyrtimit, pasi kërkesat e tyre janë deklaruar të papranueshme, në baza kushtetuese (shih, ngjashëm, rastet e Gjykatës KI159/18, parashtrues: *Azem Duraku*, Aktvendimi i 3 prillit 2019, paragrafi 91; KI13/19 parashtrues: *Fevzi Hajdari*, Aktvendimi i 12 prillit 2019, paragrafi 75; dhe së fundmi rastet e bashkuara KI19/19 dhe KI20/19, ku parashtrues ishin vet parashtruesit e kërkesave, Aktvendimi i 29 korrikut 2019, paragrafët 53-55).

Përfundim

40. Si përfundim, Gjykata arrin në konstatimin se kërkesat e parashtruesve të kërkesave:
- i. në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 748/2018, të 13 gushtit 2018, dhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 259/2018, të 5 nëntorit 2018, duhet refuzuar, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës;
 - ii. në lidhje me Aktgjykimin e kontestuar janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme, në bazë të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.
 - iii. në lidhje me vendosjen e masës së përkohshme, duhet refuzuar në pajtueshmëri me nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 27 (1) të Ligjit dhe të rregullave 35 (4) dhe 39 (2), 57 (4) (a), si dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi